

SBASHK Arsimimi Sot

Shkurt, 2026

Gazeta elektronike

Kryetare u zgjodh Flutura Demaku Zariqi, nënkryetar Afrim Çela



U mbajtën zgjedhjet e Nivelit Sindikal të Universiteteve dhe Shkencës, ku u zgjodh kryetarja, nënkryetari, kryesia e re e NSUSH-it, delegatët për Kongresin e SBASHK-ut, si dhe anëtarët për Këshillin Drejtues të SBASHK-ut.

Gjatë procesit zgjedhor në NSUSH ishin të pranishëm edhe përfaqësues të lartë të SBASHK-ut: Kryetari Rrahman Jasharaj, nënkryetarja Vjollca Shala dhe sekretari i Përgjithshëm, Ymer Ymeri, të cilët i dhanë mbështetje ecurisë së mbarë të procesit zgjedhor. ... (faqe 4)

SBASHK trajnoi qindra mësimdhënës gjatë muajit shkurt



Gjatë muajit shkurt SBASHK ka vazhduar me oranimin e grupeve të reja të trajnimit për mësimdhënës, të cilët kanë shprehur kërkesat për vijimin e këtyre programeve të trajnimit të cilat SBASHK i ofron për... (faqe 4)

SBASHK uron 17 Shkurtin, Ditën e Pavarësisë



Më 17 Shkurt shënojmë një nga ditët më të lavdishme të historisë sonë kombëtare - Ditën e Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, ditën kur ëndrra shekullore e popullit tonë u bë realitet ... (faqe 7)

Kolege e kolegë, gëzuar dhe urime 7 Marsi



Në ditët e para të muajt mars në vatrat arsimore kudo në Kosovë zhvillohen aktivitete të shumta përkujtoese... (faqe 2)

Punonjësit universitarë i përcjell problemi me koeficientë të pagës



Në një intervistë për revistën mujore "Arimimi Sot" të SBASHK-ut, Flutura Demaku-Zariqi ka thënë se do të angazhohet... (faqe 3)

Editorial

Kolege e kolegë, gëzuar dhe urime 7 Marsi



Në ditët e para të muajt mars në vatrat arsimore kudo në Kosovë zhvillohen aktivitete të shumta përkujtoese dhe lartësohet kujtimi për komandantin legjendar Adem Jashari dhe gjithë dëshmorët e kombit. Po ashtu në fillimet e këtij muaji zhvillohen aktivitete të shumta kulturore për të lartësuar kujtimin edhe për pishtarët e dijes që nëpër vite e dekada ishin në krye të misionit të shenjtë për edukimin e arsimimin e brezave.

Aktivitete festive për ditën e mësuesit dhe shkollës shqipe do të organizohen edhe nga SBASHK kudo në komunat e Kosovës dhe në universitete, dhe përmes takimeve solemne do të shprehet respekt për anëtarët e anëtarët e pensionuar nga marsi i vitit të kaluar e deri tani. Atyre do t'u ndahen mirënjohje në shenjë respekti për gjithë angazhimet në misionin e

shenjtë për edukimin e brezave nëpër vite e dekada. Është ky moment kur pjesëmarrësit e këtyre aktiviteteve lartësojnë kujtimin për mësuesit e parë të kombit dhe shprehim respektin meritor për punëtorët e arsimit shqip që nëpër vite, dekada e shekuj ishin në shërbim të edukimit e arsimimit të brezave. Ata ndjehen krenar dhe rikujtojnë momente e ngjarje të veçanta për t'u ndalur te vitet e 90-ta kur pishtarët e dijes mbronin arsimin shqip kundër pushtuesit serb që mudohej të zhdukte çdo gjë shqiptare.

Kolege e kolegë kudo jeni gëzuar dhe urime 7 Marsi, kjo ditë e madhe e mësuesit dhe shkollës shqipe. Bashkë e në SBASHK do të vazhdojmë rrugëtimin në përpjekjet e vazhdueshme për realizimin e kërkesave tuaja dhe në shërbim të një arsimit edhe më cilësor.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonjë rubrike në interes të antarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimi SOT.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të antarësisë, së shpejti do të oftojmë shërbime këshilla për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spotete në uebfaqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: **Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)** përfaqëson mbi 24.000 anëtarë në tërë territorin e Kosovës duke përfshirë edhe komunitetet, SBASHK është anëtare e Edukimit Ndërkombëtar që nga viti 1996 me drejta të plota.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel: +383 (0) 38 226 940



Bashkëbisedim

Intervistë me kryetaren e NSUSH-së, Flutura Demaku-Zariqi

Punonjësit universitarë i përcjell problemi me koeficientë të pagës



Punonjësit universitar në Kosovë vazhdojnë të ankohen rreth rangimit në Ligjin e Pagave dhe rrjedhimisht koeficientin e pagës. Në këtë nivel të arsimit, punonjësit ankohen edhe për moszbatim të rregulloreve të brendshme

për stafin administrative si dhe rregulloren për procedurat përzgjedhëse të personelit akademik.

Të gjitha këto çështje ka premtuar se do t'i adresojë dhe të avokoj për zgjidhjen e tyre, kryetarja e sapozgjedhur e Nivelit Sindikal të Universiteteve dhe Shkencës, Flutura Demaku-Zariqi.

Në një intervistë për revistën mujore “Arimimi Sot” të SBASHK-ut, Flutura Demaku-Zariqi ka thënë se do të angazhohet për përmirësimin e kushteve të punës, për paga më të dinjitetshme, siguri në vendin e punë dhe trajtim dinjitoz.

SBASHK: Znj. Demaku-Zariqi, sapo jeni zgjedhur kryetare e Nivelit Sindikal të Universiteteve dhe Shkencës (NSUSH), cilat janë ambiciet tuaja për këtë pozitë?

Demaku-Zariqi: Si kryetare e NSUSH e zgjedhur me 12 shkurt 2026, normalisht që kam për qëllim që detyrën time ka kryej me shumë përgjegjësi të pasuar me suksese. Ambicie kryesore e imja është të forcoj rolin e sindikatës si zë i fuqishëm dhe i besueshëm në nivelin universitar.

SBASHK: Në krye të Sindikatës së Universiteteve keni një numër relativisht të madh të anëtarësisë, çka synoni të arrini gjatë mandatit tuaj?

Demaku-Zariqi: Gjatë këtij mandati do të punojmë fort, bashkë me kryesinë e NSUSH-së, që të sigurojmë zbatimin e Ligjit të Punës dhe Kontratës Kolektive, si dhe të kontribuojmë që të arrijmë ta bindim Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për marrvjeshe për Kontraten e re Kolektive.

Të angazhohemi për përmirësimin e kushteve të punës, për paga më të dinjitetshme, për siguri në vendin e punë dhe trajtim dinjitoz.

Të rrisim transparencën dhe komunikimin, të mbajmë antarët të informuar dhe të përfshirë në vendimmarrje.

Të forcojmë bashkëpunimin me institucionet, të ndërtojmë dialog konstruktiv me drejtuesit dhe autoritet për zgjidhje afatgjate.

Përpjekja jonë do të jetë maksimale për të rritur numrin

e antarësisë dhe unitetin, sepse mendoj që një sindikatë e forte ndërtohet mbi solidaritetin dhe pjesë marrjen active të antarëve.

SBASHK: Cilat janë problemet me të cilat ballafaqohen anëtarët e SBASHK-ut në universitete e të cilat sipas jush kërkojnë zgjidhje urgjente?

Demaku-Zariqi: Si problem urgjent me të cilin edhe kemi qenë duke u marrë edhe sa isha Kryetare e Sindikatës së Universitetit të Prishtinës, ka qenë çështja e koeficientëve, është ende aktuale kjo çështje dhe kemi problem me rangim jo adekuat në Ligjin për Pagat të punonjësve universitar, dhe moszbatimin e rregulloreve të brendshme të Universiteteve për stafin administrativ, si dhe rregullores për procedurat përzgjedhëse të personelit akademik.

SBASHK: Cilat janë kërkesat e anëtarësisë në këtë nivel sindikal?

Demaku-Zariqi: Kjo që u tha më lartë, pra të rregullohet çështja e koeficientëve, dhe pajisja me kontrata të reja sipas rregulloreve të brendshme për sistematizimin e vendeve të punës. Këto janë si pika më urgjente.

SBASHK: Ku do të fokusoheni në shërbim të anëtarësisë si kryetare e re e NSUSH-it gjatë mandatit që sapo e keni marrë?

Demaku-Zariqi: Si kryetare e re e NSUSH-së, fokusi im do të të jetë i qartë, i dukshëm dhe i matshëm.

Po ua përmend disa pika ku do të fokusohemi gjatë këtij mandati:

- Forcimi i unitetit dhe komunikimit
- Organizimi i takimeve të rregullta me anëtarët
- Hapja e kanaleve të drejtpërdrejta të komunikimit (e-mail, grupe, sondazhe)
- Dëgjimi aktiv i shqetësimeve dhe propozimeve
- Përmirësimi i kushteve të punës
- Negociata për paga më të mira dhe kompensime shtesë
- Siguri dhe shëndet në punë
- Balancë më e mirë punë-jetë
- Transparencë dhe llogaridhënie
- Raporte periodike mbi aktivitetet dhe financat e sindikatës
- Vendimmarrje e hapur dhe përfshirëse
- Fuqizimi profesional
- Trajnime dhe zhvillim profesional për anëtarët
- Këshillim ligjor dhe mbështetje në raste konflikti
- Rritja e anëtarësisë
- Fushata informuese për përfitimet e sindikatës
- Përfshirja e të rinjve dhe punonjësve të rinj.

Gjatë muajit

U mbajtën zgjedhjet Sindikla të Universiteteve dhe Shkencës Kryetare u zgjodh Flutura Demaku Zariqi, nënkryetar Afrim Çela



U mbajtën zgjedhjet e Nivelit Sindikal të Universiteteve dhe Shkencës, ku u zgjodh kryetarja, nënkryetari, kryesia e re e NSUSH-it, delegatët për Kongresin e SBASHK-ut, si dhe anëtarët për Këshillin Drejtues të SBASHK-ut.



Gjatë procesit zgjedhor në NSUSH ishin të pranishëm edhe përfaqësues të lartë të SBASHK-ut: Kryetari Rrahman Jasharaj, nënkryetarja Vjollca Shala dhe sekretari i Përgjithshëm, Ymer Ymeri, të cilët i dhanë mbështetje ecurisë së mbarë të procesit zgjedhor.

Në fjalën e tij përshëndetëse, kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, lavdëroi punën dhe angazhimet e kryetarit të deritanishëm, Bardh Bardhi por edhe kryesisë

së këtij kuvendi. I pranishëm në këtë mbledhje ishte edhe kryetari i BSPK-së, Atdhe Hykolli, i cili i mbështeti zgjedhjet e lira dhe demokratike të organizuara nga niveli universitar i SBASHK-ut.



Zgjedhjet në Nivelin Sindikal të Universiteteve dhe Shkencës u zhvilluan në mënyrë të rregullt, demokratike dhe pa asnjë pengesë. Kryetare e NSUSH-it u zgjodh Flutura Demaku, kurse nënkryetar Afrim Çela.



Ky kuvend u organizua në kuadër të zgjedhjeve të rregullta, të cilat ishin shpallur në vitin 2025 dhe ishin mbajtur në të gjitha shoqatat sindikale, për të vazhduar edhe në të gjitha nivelet komunale, universitare dhe të kulturës që veprojnë në kuadër të SBASHK-ut.

SBASHK trajnoi qindra mësime të gjatë muajit shkurt SBASHK vazhdoi me grupe të reja të trajnimit edhe në shkurt

Gjatë muajit shkurt SBASHK ka vazhduar me oranimin e grupeve të reja të trajnimit për mësime të gjatë, të cilët kanë shprehur kërkesat për vijimin e këtyre programeve të trajnimit të cilat SBASHK i ofron për anëtarësinë pa pagesë.

Në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësime të gjatë” dhe “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social”, SBASHK filloi vikendin e fundit të shkurtit me dy grupe të trajnimit, një në Klinë dhe një në Viti.



Në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, një gurrp filloi në Klinë, me trajner Burim Krasniqi, derisa mësimdhënësit i vizitoi edhe kryetarja e NSKAP-it për këtë komunë, Njomza Limanaj e cila u dëshiroi punë të mbarë dhe suksese në zhvillimin profesional. Kurse në Viti filloi një grup i trajnimit në programin “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social”, me trajneren e përcaktuar nga SBASHK, Makfirete Zuka. Edhe mësimdhënësit e Vitisë i vizitoi kryetari i NSKAP-it për këtë komunë, Kemajl Bislimi, i cili u kujdes për mbarëvajtjen e trajnimit dhe ofrimin e kushteve sa më të përshtatshme për ndjekjen e trajnimit.



Një javë më parë SBASHK mbajti testet për tri grupe të trajnimit në Dragash, të cilët më parë e kishin përfunduar trajnimin në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, dy grupe në modulën e dytë të këtij program dhe një grup në modulën e parë.



Testet ishin administruar nga sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri dhe zyrtaret Nezafete Jakupi dhe Drita Vitia Zeneli. I pranishëm gjatë testimit ishte edhe kryetari i NSKAP-it për Dragash, Vloran Krasniqi si dhe trajnerët të cilët i kishin udhëhequr trajnimet, Arton Ajeti dhe Admir Halimi.




Ndërkohë, në javën e dytë të shkurtit SBASHK kishte filluar edhe me tri grupe të trajnimit kurse kishte organizuar testet edhe për tetë grupe tjera.



Në Prishtinë të shtunën kishin filluar dy grupe të trajnimit në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, me traneret e përcaktuara nga SBASHK, Dorentinë Demaku dhe Blerona Ahmeti.



Mësimdhënësit i kishte vizituar kryetari i NSKAP-it për Prishtinë, Qamil Hajdini, i cili ishte kujdes për mbarëvajtjen e trajnimit dhe u kishte uruar mësimdhënësve arritje sa më të larta profesionale.



Një grup i trajnimit në po të njëjtin program kishte filluar edhe në Viti, me trajnerin e përcaktuar nga SBASHK, Musli Neziri. Edhe në Viti kishte qëndruar kryetari i NSKAP-it Kemajl Bislimi, i cili ishte kujdes për mbarëvajtjen e rregullt të trajnimit.



Ndërkohë, gjatë ditës së shtunë SBASHK kishte organizuar edhe pesë grupe të testimit për mësimdhënësit të cilët e kishin ndjekur dhe përfunduar më parë këtë trajnim, nga komuna e Shtimes dhe Gjilanit.




Në Gjilan SBASHK kishte organizuar dy grupe të testimit në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” -moduli 1 dhe 2. Mësimdhënësit e modulit të parë ishin udhëhequr nga trajnerja Ibadete Limoni, kurse ata të modulit të dytë nga trajneri i përcaktuar nga SBASHK, Musli Neziri.



Testi në Gjilan ishte administruar nga sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri dhe zyrtarja administrative, Shukrie Gori Markovic. Mësimdhënësit në Gjilan i kishte vizituar edhe kryetari i NSKAP-it në këtë komunë, Blerim Mehmeti si dhe kryetari i NSKAP-it të Novobërdës, Besnik Kurteshi.

Kurse në Shtime SBASHK kishte organizuar tri grupe të testimit në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, dy në modulën e dytë dhe një në modulën e parë.



Testet në Shtime ishin administruar nga nënkryetarja e SBASHK-ut, Vjollca Shala dhe zyrtari Ligjor, Blendor Shatri. Edhe mësimdhënësit e Shtimes i kishte vizituar kryetari i NSKAP-it për këtë komunë, Bekim Krasniqi.



Grupet e modulit të dytë në Shtime ishin udhëhequr nga trajnerët Dorentinë Demaku dhe Arben Zymeri, kurse ai i modulit të parë ishte udhëhequr nga trajnerja Blerona Ahmeti.


Ndërkohë, qysh në fillim të muajit hskurt SBASHK kishte filluar edhe me katër grupe të trajnimit në programin “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social” në Kaçanik dhe Fushë-Kosovë.



Në Kaçanik SBASHK kishte filluar me tri grupe të trajnimit në programin “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social”, të cilat ishin udhëhequr nga trajnerët e përcaktuar nga SBASHK, Hysen Sogojeva, Emrush Ahmeti dhe Ramadan Gashi.



Me fillimin e trajnimit, mësimdhënësit i kishte vizituar edhe kryetari i NSKAP-it për Kaçanik, Islam Berisha, i cili ishte kujdes për mbarëvajtjen e trajnimit dhe u kishte uruar mësimdhënësve arritje sa më të larta profesionale.



Kurse në Fushë-Kosovë kishte filluar një grup i trajnimit në po të njëjtin program “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje efektive të dialogut social” nën udhëheqjen e trajnerit, Blendor Shatri. Edhe mësimdhënësit e Fushë-Kosovës i kishte vizituar kryetari i NSKAP-it për këtë komunë, Haki Krasniqi, i cili ishte kujdes që trajnimi të fillojë mbarë.

SBASHK uron 17 Shkurtin, Ditën e Pavarësisë Të nderuar anëtare dhe anëtarë të SBASHK-ut,



Më 17 Shkurt shënojmë një nga ditët më të lavdishme të historisë sonë kombëtare - Ditën e Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, ditën kur ëndrra shekullore e popullit tonë u bë realitet.

Por 17 Shkurti i vitit 2026 është edhe më i veçantë. Këtë herë, ai na gjen të bashkuar si kurrë më parë rreth një thirrjeje të fuqishme qytetare: “Drejtësi, jo politikë!” – një zë i përbashkët në mbrojtje të çlirimtarëve tanë, të cilët prej më shumë se pesë vitesh po përballen me procese në Hagë, larg familjeve dhe atdheut për të cilin sakrifkuan gjithçka.

Populli i Kosovës ka ditur gjithmonë të qëndrojë në anën e drejtësisë. Ka ditur të bashkohet në momentet më të mëdha historike. Dhe në të gjitha këto procese shtetformuese, ju – anëtarët e SBASHK-ut – keni qenë në ballë të përgjegjësisë kombëtare: në vitet e rezistencës, në kohën e sakrificës, në ndërtimin e institucioneve dhe në forcimin e shtetit tonë.

Edhe kësaj radhe, historia na thërret.

Ju ftojme që nesër, masovikisht, së bashku me familjet tuaja, të bëhemi pjesë e marshit qytetar dhe të mbushim sheshet e Kryeqytetit me dinjitet, me qetësi dhe me krenari kombëtare. Le të dëgjohet fuqishëm zëri ynë për drejtësi. Le të dëshmojmë se mirënjohja ndaj atyre që kontribuuan për lirinë tonë është vlerë e patjetërsueshme.

17 Shkurti është festë. Është krenari. Është përgjegjësi.

Të dalim së bashku, me flamurin kuqezi dhe me flamurin e shtetit tonë, me zemër plot dashuri për atdheun dhe me besim të palëkundur në drejtësi.

Lavdi të gjithë atyre që sakrifkuan për lirinë! Urime Dita e Pavarësisë!

Me respekt dhe krenari.

SBASHK përkrahu marshin qytetar “Drejtësi, jo politikë!” Për mobilizim qytetar dhe sindikal



Të nderuar anëtarë të SBASHK-ut, arsimtarë, mësues, profesorë dhe punëtorë të arsimit në të gjitha nivelet, Kryesia e SBASHK-ut, pas konsultimeve me strukturat sindikale në të gjithë vendin, ju fton për mobilizim qytetar dhe sindikal në përkrahje të Marshit qytetar “Drejtësi, jo politikë!”, të organizuar nga platforma “Liria ka Emër”, më 17 shkurt, në Ditën e Pavarësisë së Republikës së Kosovës, në Prishtinë. Ky marsh është jo politik dhe përfaqëson një thirrje të ndershme për drejtësi të paanshme, si dhe për respektimin e sakrificës së çlirimtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilët prej më shumë se pesë vitesh po mbahen padrejtësisht në paraburgim. Për SBASHK-un, kjo çështje ka

peshë të veçantë sindikale dhe historike. Shumë nga çlirimtarët ishin edhe arsimtarë e punëtorë arsimit, të larguar dhunshëm nga vendet e punës gjatë regjimit të Millosheviqit. Në vitet e okupimit, ishin mësimdhënësit ata që mbajtën gjallë arsimin shqip, dinjitetin kombëtar dhe shpresën për liri. Falë sakrificës së tyre, falë luftës së drejtë të UÇK-së dhe përkrahjes së aleatëve tanë ndërkombëtarë, sot jetojmë në një shtet të lirë dhe sovran. Sot, kur ata që sakrifkuan për lirinë po përballen me padrejtësi të zgjatura, heshtja nuk është opsion. Dalja në këtë marsh nuk është akt politik, por akt moral dhe qytetar. Është shprehje e ndërgjegjes sonë kolektive dhe vazhdimësi e misionit sindikal për mbrojtjen e dinjitetit njerëzor dhe të së vërtetës. SBASHK-u qëndron qartë në anën e drejtësisë, të dinjitetit dhe të solidaritetit shoqëror. I ftojme të gjithë anëtarët e SBASHK-ut që, në mënyrë vullnetare, pa asnjë detyrim dhe larg çdo angazhimi politik, t'i bashkohen Marshit “Drejtësi, jo politikë!”, për të dhënë një mesazh të fuqishëm uniteti dhe kërkesë për drejtësi të paanshme. Pjesëmarrja juaj është: zë për drejtësinë, respekt për sakrificën, dhe përgjegjësi ndaj historisë sonë. Me solidaritet sindikal, Kryesia e SBASHK-ut

Zgjedhjet Sindikale në Istog

Kryetar u rizgjodh Muzli Blakaj, ndërsa nënkryetare Ermira Haliti



Në Istog gjatë muajit shkurt u mbajt Kuvendi Zgjedhor i Nivelit Sindikal Komunal të Arsimit Parauniversitar (NSKAP), ku u zgjodhën kryetari, nënkryetarja, kryesia e re e NSKAP-it

të Istogut, delegatët për Kongresin e SBASHK-ut, si dhe anëtarët për Këshillin Drejtues të SBASHK-ut.




Gjatë procesit zgjedhor në Istog ishin të pranishëm edhe përfaqësues të lartë të SBASHK-ut: Kryetari Rrahman Jasharaj dhe zyrtari Ligjor, Blendor Shatri. Procesi zgjedhor në Istog ishte zhvilluar në mënyrë të rregullt, demokratike dhe pa asnjë pengesë. Kryetar i NSKAP-it të Istogut ishte rizgjedh Muzli Blakaj, ndërsa nënkryetare, Ermira Haliti.

Kuvendi i NSKAP-it të Istogut i kishte propozuar Kongresit të SBASHK-ut kandidaturën e z. Blendor Shatri për Kryetar të SBASHK-ut, ndërsa propozoi që z. Ymer Ymeri t'i vazhdohet edhe një mandat si Sekretar i Përgjithshëm i SBASHK-ut.

Ky kuvend u organizua në kuadër të zgjedhjeve të rregullta, të cilat ishin shpallur në vitin 2025 dhe ishin mbajtur në të gjitha shoqatat sindikale, për të vazhduar edhe në të gjitha nivelet komunale, universitare dhe të kulturës që veprojnë në kuadër të SBASHK-ut.



SBASHK – REAGIM DHE MBËSHTETJE PËR GREVË DY-ORËSHE



SINDIKATA E BASHKUAR E ARSIMIT, SHKENCËS DHE KULTURËS E KOSOVËS

Të nderuar kolegë,
Me shqetësim të thellë, Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK) dënon sulmin fizik ndaj një mësimitdhënësi në Shkollën “Pavarësia” në Prishtinë, si dhe rastet e përsëritura të fyerjeve, ofendimeve dhe sulmeve verbale ndaj mësimitdhënësve nga nxënës dhe, në disa raste, nga prindërit.

Këto raste nuk mund të trajtohen si incidente të izoluar, pasi dhuna dhe mosrespektimi ndaj mësimitdhënësve po cenojnë rëndë dinjitetin e profesionit dhe sigurinë e procesit edukativo-arsimor.

SBASHK mbështet grevën dy-orëshe të organizuar nga Sindikata e Shkollës “Pavarësia”, si pjesë e SBASHK-ut, që do të zhvillohet nesër në këtë shkollë, për të kërkuar reagim të menjëhershëm dhe masat e duhura nga institucionet përkatëse.

Ne kërkojmë nga organet përkatëse të sigurisë që:

Të hetojnë rastin në mënyrë të shpejtë dhe të drejtë. Të dalin të dhënat e vërteta në dritë dhe të merren masat e duhura ndaj nxënësve dhe personave përgjegjës.

Po ashtu kërkojmë përgjegjësi institucionale nga menaxhmenti i shkollës dhe Drejtoria e Arsimit, si dhe zbatim të plotë të rregulloreve disiplinore për të parandaluar raste të ngjashme në të ardhmen.

Nëse nuk ka reagim të shpejtë dhe masa konkrete ndaj këtij rasti, SBASHK në nivelin komunal në Prishtinë do të shqyrtojë mundësinë e ndërprerjes së mësimit edhe në shkollat tjera, për të mbrojtur mësimitdhënësit dhe për të garantuar një mjedis të sigurt dhe të respektueshëm në arsimin publik.

Kjo formë e veprimit sindikal nuk është qëllim në vetvete, por mjet i fundit për të siguruar respektimin e ligjit, dinjitetit profesional dhe sigurisë në shkolla. SBASHK – Për mësimitdhënësit, për arsimin, për respektin!